


# FEDERATA SHQIPTARE E GJIMNASTIKËS

## FEDERATA SHQIPTARE E GJIMNASTIKËS

### STATUT



PULLE TARIFE



TIRANË 2024



16.01.2024.  
 VERIFIKOHET NJESIA NE  
 ORIGINALIN FQ 29.  
 SEKRETAR I REGJISTRIT

*Beshtetja*  
*[Signature]*



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"

7

## STATUTI I FEDERATËS SHQIPTARE TË "GJIMNASTIKËS"



### Hyrje

Ky statut është dokumenti themelor mbi bazën e të cilit do të drejtohet Federata Shqiptare e "Gjimmastikës"

Federata Shqiptare e Gjimmastikës është themeluar më 2 Shtator të vitit 1945.

Federata Shqiptare e "Gjimmastikës", është person juridik, organizatë, i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas Vendimit Numër 2638, të datës 28.09.2009.

Ky statut është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të "Gjimmastikës", Vendim nr.6 të datës 16/12/2023.

### KREUI

#### PARIME TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### Emri, forma dhe adresa

1. Federata Shqiptare e "Gjimmastikës" (për efekt të këtij statuti më poshtë do t'i referohemi si FSHGJ) është person juridik privat që krijohet në formën e shoqatës, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave sportive, shoqërive sportive dhe klubeve sportive të Federatës Shqiptare të Gjimmastikës në Republikën e Shqipërisë.
2. Federata Shqiptare e "Gjimmastikës" vepron në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 79/2017, datë 27.04.2017 "Për Sportin", i ndryshuar, ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, ligji nr.80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitim prurëse" i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto aktivitete dhe që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Federata Shqiptare e "Gjimmastikës", përdor shkurtimein zyrtar FSHGJ.
4. Federata Shqiptare e Gjimmastikës si anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gjimmastikës, respekton Statutin dhe rregulloret, direktivat dhe vendimet e saj dhe siguron respektimin e tyre nga të gjithë anëtarët e saj.

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"

5. FSHGJ e ka selinë e saj qendrore në adresën Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik "Feti Borova", 1001 Tiranë.
6. FSHGJ është themeluar me afat të papërcaktuar.

## Neni 2

### Flamuri, stema, logo dhe vula



1. Flamuri, logo, stema dhe vula janë simbolet e FSHGJ-së.
  - a. Sigla e Federatës Shqiptare të Gjymnastikës është FSHGJ.
  - b. Flamuri i FSHGJ-së është me ngjyrë të kuqe në sfond, nga njëra anë ka mbishkrimin "Federata Shqiptare e Gjymnastikës" dhe logon e Federatës dhe nga ana tjetër Shqiponjën dykrenare.
  - c. Logoja e FSHGJ-së është në formë rrethore, një element gjymnastikor i stilizuar shoqëruar me FSHGJ.
  - d. Vula e FSHGJ-së është në formë rrethore, sipër Republika e Shqipërisë, poshtë saj në formë rrethore shkruhet Federata Shqiptare e Gjymnastikës, në qendër stema e Republikës ndërsa në pjesën e poshtme-Tiranë
2. Prodhimi, administrimi dhe asgjësimi i vulës zyrtare të FSHGJ-së bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e vulave dhe dokumentacionit zyrtar.

## Neni 3

### Qëllimi, fusha e veprimitarisë dhe objektivat

1. FSHGJ-ja është themeluar me qëllim zhvillimin, promovimin, kontrollimin dhe rregullimin e aktiviteteve në sportin e gjymnastikës, në të gjitha disiplinat e saj, si në gara si edhe në aktivitete jashtë gare. Disiplinat e sportit të gjymnastikës janë ato të sportit të gjymnastikës, të përcaktuara zyrtarisht dhe të njohura nga Federata Ndërkombëtare e Gjymnastikës (FIG).
2. Të ardhurat dhe fitimet e FSHGJ-së do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të FSHGJ-së dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të organizatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJF-së. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.
3. FSHGJ-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka këto objektiva:

Adresa: Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



- a. Të zhvillojë, promovojë, kontrollojë dhe rregullojë aktivitetin sportiv të Shoqatave Klubeve dhe të shoqërive sportive të FSHGJ-së, në të gjitha format e tij e në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë statut.
  - b. Të ndihmojë në mënyrë të kualifikuar në rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve profesionale midis anëtarëve të FSHGJsë, si dhe të mbrojë të drejtat e anëtarëve të saj dhe kujdeset për zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative sportive, duke u mbështetur në Statut, në Rregulloren e saj, legjislacionin Shqiptar si edhe aktet ligjore ndërkombëtare të veprimtarisë së sportit përkatës.
  - c. Të marrë masa për ndalimin e diskriminimit në veprimtaritë sportive për shkaqe, si bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike ose shoqërore.
  - d. Të përdorë eksperiencën e saj për të ndihmuar rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis anëtarëve të FSHGJ-së, duke inkurajuar frymën e tolerancës, të mirëkuptimit dhe lojës së drejtë (Fair Play) në të gjitha nivelet e garave.
  - e. Të organizojë Kampionatin Kombëtar dhe Kupën e Shqipërisë dhe të shpallë ekipin fitues të kupës së Shqipërisë në sportin e vet
  - f. Të aderojë në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar.
  - g. Të organizojë ekipet kombëtare të të gjitha kategorive dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari.
  - h. Të organizojë në Republikën e Shqipërisë veprimtari sportive ndërkombëtare me miratimin e ministrisë përgjegjëse për sportin dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e vet.
  - i. Të licensojë trajnerë për sportin e Gjimnastikës.
  - j. Të koordinojë dhe japë pëlqimin për kryerjen e veprimtarive dhe garave sportive për anëtarët e saj.
  - k. Të autorizojë përdorimin e simboleve të federatës nga anëtarët e saj përmes parashikimeve në rregulloren e brendshme të FSHGJsë.
  - l. Të organizojë, administrojë dhe kontrollojë disiplinën/disiplinat në sportin e Gjimnastikës në Republikën e Shqipërisë.
  - m. Disiplinat e sportit të gjimnastikës përfshijnë; gjimnastikën artistike për femra dhe gjimnastikë artistike për meshkuj, gjimnastika për të gjithë, gjimnastikë ritmike, gjimnastikë akrobatike, gjimnastikë aerobike, trampolina dhe parkour.
  - n. Të mbrojë interesat e përbashkëta të shoqatave të Gjimnastikës dhe të anëtarëve të saj.
4. Të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në federatat ndërkombëtare përkatëse të Gjimnastikës

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"

10



## KREU II

### ANËTARËSIA NË FSHGJ


#### Neni 4 Anëtarësimi

1. Anëtarët e FSHGJ-së krijohen në një nga format ligjore të parashikuara në ligjin për sportin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Anëtarët e FSHGJ-së mund të jenë persona juridikë, klube sportive, shoqata sportive apo shoqëri sportive, të cilat paraqesin dokumentat themeluese të tyre si dhe dokumentat e tjerë të përcaktuar nga FSHGJ-ja.
3. Pas regjistrimit në gjykatë si person juridik, klubi sportiv, shoqëria sportive ose shoqata sportive mund të kërkojnë të drejtën e anëtarësisë pranë FSHGJ-së.
4. Çdo kërkesë për t'u anëtarësuar në FSHGJ-ës duhet të depozitohet me shkrim pranë Sekretariatit.
5. Procedura për marrjen e të drejtës së anëtarit të FSHGJ-së si dhe kriteret për të fituar këtë të drejtë përcaktohen në rregulloren për anëtarësim që miratohet nga Komiteti Drejtues. Komiteti Drejtues i FSHGJ-së i jep kërkuarit të drejtën e të qenit anëtar provizor i FSHGJ-së, deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të radhës.
6. Komiteti Drejtues i FSHGJ-së i jep kërkuarit të drejtën e të qenit anëtar provizor i FSHGJ-së, deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të radhës.
7. Asambleja e Përgjithshme e FSHGJ-së vendos mbi anëtarësinë e një anëtari, por ajo nuk mund ta refuzojë atë për sa kohë kërkesa është në përputhje me Statutin dhe rregulloret e FSHGJ-së.
8. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme duhet të jetë i arsyetuar.
- 8/1. Kundër vendimit të Asamblesë së Përgjithshme mund të paraqitet ankim në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS).
9. Për t'u anëtarësuar në FSHGJ, secili i interesuar duhet të pranojë Statutin dhe të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të organizatës.
10. Anëtarët e regjistruar të FSHGJ janë të detyruar të kontribuojnë për FSHGJ-në nëpërmjet pagimit të kuotizacioneve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
11. Selia e një anëtari të FSHGJ-së duhet të jetë në territorin shqiptar.
12. Anëtarët e FSHGJ-së kanë të drejtë të marrin dëgjimin për të gjithë vendimet për veprimtaritë sportive të FSHGJ-së. Njoftimi në këto raste kryhet nëpërmjet dërgimit të një njoftimi nga Sekretariati i FSHGJ-së

#### Neni 5


#### Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve

1. Anëtari i FSHGJ-së ka të drejtë:
  - a. Të pajiset me kartën e anëtarësimi;



Adresa: Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.






- b. Të pajiset me Statutin dhe Rregulloret e FSHGJ-së;
  - c. Të përfaqësohet me të drejta vote në Asamblenë e Përgjithshme
  - d. Anëtarët e FSHGJ-së të organizuar sipas një nga formave ligjore të parashikuara në ligjin për sportin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mund të përfaqësohen me të drejtën e 1 (një) vote në Asamblenë e Përgjithshme.
  - e. Të informohet me veprimtarinë e FSHGJ-së si dhe me vendimet e Këshillit Drejtues të FSHGJ-së
  - f. Të pajiset falas me botimet e ndryshme që mund të bëjë FSHGJ-ja;
  - g. Të marrë pjesë në aktivitete zyrtare e miqësore, kombëtare e ndërkombëtare që organizon FSHGJ-ja.
  - h. Të njihet më parë me programin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe dokumentacionin përkatës dhe të ftohet në takim në kohën e përcaktuar.
2. Anëtari provizor ka të drejtë të përfitojë të drejtat e parashikuar në germa b., d., g., të pikës 1. të këtij neni.
3. Anëtari i FSHGJ-së ka këto detyrime:
- a. Të pranojë dhe të zbatojë Statutin, direktivat, vendimet dhe Rregulloret e FSHGJ-së dhe organizmave ndërkombëtare.
  - b. Të paguajë detyrimet financiare ndaj FSHGJ-së.
  - c. T'i komunikojë FSHGJ-së çdo ndryshim në Statutet dhe Rregulloret e anëtarit, si dhe listë të personave ose zyrtarëve me të drejtë firme për të hyrë në marrëveshje ligjore me palët e treta.
  - d. Të zgjedhë organet drejtuese, ekzekutive dhe nëse e gjykon të arsyeshme dhe organin e saj disiplinor.
  - e. Të njohë parimet e ndershmërisë, *fair play*-it, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive.
  - f. Të njohë të gjitha detyrimet e tjera që dalin nga Statuti, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHGJ-së.
  - g. Të mos lejojë asnjë person të marrë pjesë në asnjë veprimtari sportive të Gjimnastikës, pa u anëtarësuar më parë pranë FSHGJ-së.
  - h. Anëtarët e FSHGJ-së duhet të integrojnë në statutet e tyre detyrimet e lartpërmendura. Shkelja e detyrimeve të lartpërmendura nga ndonjë anëtar mund të sjellë sanksione të parashikuara në këtë Statut.

Neni 6

**Pezullimi, përjashtimi dhe dorëheqja e anëtarit**

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Boreva, Tiranë.





1. Pezullimi apo përjashtimi i anëtarit bëhet me vendim të arsyetuar të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Pezullimi i anëtarit të FSHGJ-së ndodh në rastin e konstatimit të shkeljeve të Statutit, Rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHGJsë.
3. Afatet e pezullimit janë:
  - a. Për shkelje të rregulloreve, deri në 1 vit.
  - b. Për shkelje të vendimeve, deri në 1 vit.
  - c. Për shkelje të përcaktimeve statutore, nga 6 muaj deri në përjashtim përgjithmonë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
  - d. Për mospagim të kuotizacionit, jo më shumë se 1 vit.
4. Vendimi që mund të marrë Asambleja e Përgjithshme, për pezullim me afat nuk mund të jetë më shumë se një vit.
5. Statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e tij.
6. Përjashtimi i anëtarit ndodh në rast të mospagimit të kuotizacionit vjetor për dy vite rradhazi. Përjashtimi i anëtarit nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërbushura kundrejt FSHGJ-së.
7. Dorëheqja e anëtarit bëhet me kërkesë me shkrim. Bashkëlidhur saj, duhet të paraqitet vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të anëtarit të FSHGJ-së.  
Akti i pranimit të dorëheqjes del brenda dy javësh nga kërkesa për dorëheqje. Pranimi i dorëheqjes nuk e liron anëtarin nga detyrimet e papërbushura kundrejt FSHGJ-së.

### KREU III ORGANIZIMI

#### Neni 7

#### Organet dhe autoritetet drejtuese të FSHGJ-së

1. Organet dhe autoritetet drejtuese të FSHGJ-së janë :
  - a. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës.
  - b. Komiteti Drejtues është organi më i lartë ekzekutiv
  - c. Sekretariati i Përgjithshëm është organ administrativ.
  - d. Presidenti është autoriteti më i lartë i FSHGJ-së në marrëdhënie me të tretët.
2. Pranë FSHGJ-së funksionojnë komisione për përmbushjen e qëllimit dhe funksionimit të saj.
3. Komisionet janë :
  - a. Komisioni teknik dhe i gjykimit

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



- b. Komisioni i financës dhe Projekteve
- c. Komisioni i Disiplinës
- d. Komisioni i Apelit
- e. Komisioni Sportiv
- f. Komisioni i Edukimit
- g. Komisioni i Vlerësimit.

## Neni 8

### Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i FSHGJ-së dhe përfaqëson autoritetin më të lartë të saj.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga tërësia e të gjithë anëtarëve e saj, të cilët kanë të drejtën e 1 (një) votë.
3. Në Asambleshë e Përgjithshme marrin pjesë pa të drejtë vote, anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, Anëtarët e Komitetit Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm i FSHGJ-së.
4. Personat e përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, nuk kanë të drejtë vote dhe mund të diskutojnë vetëm me leje të drejtuesit të Asamblesë.
5. Asambleja e Përgjithshme ka përgjegjësinë më të lartë për përcaktimin e fushës dhe veprimtarisë si dhe çështjet financiare të FSHGJ-së.

## Neni 9

### Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
  - a. Miraton ndryshime të Statutit të FSHGJ-së;
  - b. Mbikqyr dhe kontrollon përmbushjen e vendimeve, rregulloreve, direktivave të miratuara prej saj;
  - c. Miraton buxhetin, raportet financiare dhe të punës të Federatës.
  - d. Miraton kompaninë audituese të pavarur që ka eksperiencën dhe kualifikimin e nevojshëm për auditimin e llogarive financiare, sipas procedurave dhe përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
  - e. Zgjedh Presidentin e Federatës si dhe anëtarët e Komitetit Drejtues me votim të fshehtë.
  - f. Miraton rregulloren për funksionimin e Komitetit Drejtues dhe organit administrativ.

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.





- g. Miraton propozimet e anëtarëve për dhënie të titujve të nderit brenda jurisdikcionit të FSHGJ-së..
  - h. Miraton pranimin, pezullimin, përjashtimin apo dorëheqjen e një anëtari sipas parashikimit në këtë Statut.
  - i. Deklaron shkrirjen e Federatës dhe likuidimin e veprimeve të saj financiare.
  - j. Miraton Kalendarin e aktiviteteve të propozuara nga Komiteti Drejtues.
2. Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme, të parashikuara në nenin 20 të ligjit nr 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" nuk mund të delegohen në organet tjera.
  3. Asambleja mund të delegojë kompetenca të tjera përmes vendimit të saj të marrë me shumicën e anëtarëve të saj.
  4. Asambleja e përgjithshme miraton rregulloren e disiplinës, kodin e etikës, rregullore për organizimin e zgjedhjeve dhe votimit dhe rregullore të tjera të nevojshme për ecurinë dhe realizimin e qëllimit të FSHGJsë.


#### Neni 10

#### Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja mbledhet në mbledhje të zakonshme jo më pak se një herë në vit, por ajo mund të mbledhet edhe në mbledhje të jashtëzakonshme kur thirret nga:
  - a. Presidenti i FSHGJsë;
  - b. Kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të Asamblesë; Kërkesa i drejtohet Presidentit të Asamblesë, i cili ka detyrimin për thirrjen dhe organizimin e mbledhjes njoftimin me shkrim të të gjithë anëtarëve duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës. Njoftimi për mbledhjen do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku 7 (shtatë)ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
2. Mbledhja e zakonshme e FSHGJ-së thirret nga Komiteti Drejtues i cili përcakton edhe rendin e ditës. Njoftimi, rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër duhet t'u dërgohet anëtarëve 30-ditë përpara datës së zhvillimit të saj.
3. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë përfshirjen në rendin e ditës të një çështjeje përmes një kërkesë e cila duhet të paraqitet tek Komiteti Drejtues të paktën 20 ditë përpara mbledhjes. Komiteti Drejtues, shqyrton propozimin dhe në rast se e pranon atë duhet të t'u dërgojë anëtarëve brenda 10 ditëve përpara datës së mbledhjes së Asamblesë, rendin e ditës të ndryshuar.
4. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së anëtarëve.
5. Vendimet në Asamblesë së Përgjithshme do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.
6. Në mbledhjet e Asamblesë mund të ftohen të marrin pjesë pa të drejtë vote, anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, anëtarët e Komitetit Drejtues, Sekretari



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



- i Përgjithshëm FSHGJ-së, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për sportin apo të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Të ftuarit mund të diskutojnë pas lejes së dhënë nga Presidenti i Asamblesë.
7. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshohet apo shfuqizohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
  8. Asnjë anëtar i Asamblesë së Përgjithshme nuk i lejohe të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje kur ai është në kushtet e konfliktit të interesit.
  9. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
  10. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Presidenti dhe në mungesë të tij nga personi i deleguar që mund të jetë zv. Presidenti ose anëtar i më i vjetër i Komitetit Drejtues.

## Neni 11


### Përfaqësimi i anëtarëve në Asamblenë e Përgjithshme

1. Çdo anëtar i FSHGJ-së përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme me një përfaqësues, i zgjedhur në Asamblenë e Përgjithshme të shoqatës, klubit, apo shoqërisë sportive.
2. Çdo anëtar dërgon në FSHGJ, në rrugë zyrtare, dokumentacionin e përfaqësuesit të tij të zgjedhur. Dokumentacioni përmban autorizimin e anëtarit me emrin e përfaqësuesit të tij të zgjedhur shoqëruar me vendimin përkatës të Asamblesë së Anëtarit. Ky dokumentacion dërgohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm, jo më vonë se 20 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë.
3. Ky përfaqësues ka të drejtën e votës në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
4. Në takimet e Asamblesë së Përgjithshme, përfaqësuesi i çdo anëtarit duhet të disponojë një dokument ligjor të identifikimit (kartë identiteti/pasaportë).
5. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtarit tjetër.
6. Votimi me prokurë nuk lejohet.

## Neni 12 Zgjedhjet

1. Zgjedhjet në FSHGJ-së bëhen me votim të fshehtë. Ato janë periodike në cdo katër vjet.
2. Presidenti dhe anëtarët e Komitetit Drejtues zgjidhen me votim të fshehtë.
- 2/1. Presidenti dhe anëtarët e Komitetit Drejtues zgjidhen për një periudhë 4-vjecare dhe jo më shumë se 3 herë (gjithsej 12 vite).

Adresa: Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



3. Të drejtën për të kandiduar për postin e presidentit e ka çdo anëtar i Asamblesë Përgjithshme.
4. Çdo kandidat ka të drejtën të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij.
5. Kandidati për president duhet të përmbushë këto kritere:
  - a. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
  - b. Të ketë arsim të lartë.
  - c. Të ketë figurë të pastër morale;
  - d. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës prerë për kryerjen e një vepre penale nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja;
  - e. Të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesave me postin e Presidentit;
  - f. Të ketë kontribuar mundësisht në fushën e sportit si sportist, trajner, gjyqtar, gazetar sportiv apo donator (financues).
6. Të drejtën për të kandiduar në postin e presidentit e kanë anëtarët e Asamblesë që përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni.
7. Në raundin e parë, Presidenti ka nevojë për 2/3 e votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin këtë shumicë, bëhet një raund i dytë zgjedhesh midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në raundin e parë. Në raundin e dytë, kandidati që merr më shumë vota zgjidhet President. Në rastet e votave të barabarta, votimi do të përsëritet. Nëqoftëse edhe votimi i dytë përfundon me rezultat të barabartë, vendimi merret nëpërmjet hedhjes së shortit nga Komisioni i numërimit.
8. Kandidatë për anëtarë të Komitetit Drejtues, zgjidhen nga lista e personave që janë propozuar për anëtarë të këtij Komiteti, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave të gjithë anëtarëve.
9. Emrat e kandidatëve, bashkë me CV e tyre duhet të dërgohen nga anëtarët në Sekretariatit e Përgjithshëm të FSHGJ-së. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon kandidaturat dhe ia paraqet rezultatet Komitetit Drejtues për miratim. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet përfaqësuesve të anëtarëve së bashku me rendin e ditës së Asamblesë. Për këtë veprimtari, Komiteti Drejtues duhet të ngrëjë një komision të posaçëm për seleksionimin e kandidaturave, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Statut.
10. Kandidatët për anëtarë të Komitetit Drejtues duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni.
11. Mënyra e organizimit të zgjedhjeve, procedura e ndjekur, njoftimet, afatet, përcaktohen në rregulloren e organizimit të zgjedhjeve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.
12. Një anëtar i FSHGJ-së mund të propozojë një kandidat për anëtar të Komitetit Drejtues dhe një kandidat për President.

Adresa: Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"

17

## Neni 13



**Komiteti Drejtues** është organi drejtues ekzekutiv i FSHGJ-së.

1. Ai përbëhet nga 7 anëtarë me këtë strukturë: Presidenti dhe 6 anëtarë.
2. Komiteti Drejtues ka këto kompetenca:
  - a. Menaxhon dhe drejton punët e FSHGJ-së në përputhje me Statutin dhe siguron zbatimin e tij.
  - b. Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm me propozim të Presidentit.
  - c. Përgatit dhe mban Asamblenë e Përgjithshme të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.
  - d. Rishikon pasqyrën e llogarive dhe harton buxhetet.
  - e. Harton raportin për aktivitetet e federatës.
  - f. Emëron, pezullon ose shkarkon anëtarët e Komisioneve të përhershëm ose të përkohshme.
  - g. Harton rregulloret dhe i paraqet ato për miratim në Asamblenë e Përgjithshme.
  - h. Propozon në Asamblenë e Përgjithshme ndryshime statutore apo ndryshime të akteve të tjera të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
  - i. Zgjedh midis anëtarëve të tij zëvendës-presidentin.
3. Rregullat e punës së anëtarëve të Komiteti Drejtues përcaktohen në rregulloren e posaçme të funksionimit të tij, e cila aprovohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash.
4. Anëtarët e Komiteti Drejtues mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Komiteti Drejtues, Asambleja e Përgjithshme duhet të zgjedhë anëtarin pasardhës për të ushtruar funksionet për kohën e mbetur.
6. Vendimet në Komitet Drejtues merren me shumicë votash të anëtarëve.
7. Komiteti Drejtues mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje Asamblesë së Përgjithshme për marrje të vendimit.
8. Asnjë anëtar i Komitetit Drejtues nuk i lejohe të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

## Neni 14

### Sekretariati i përgjithshëm

1. Sekretariati i përgjithshëm është organi administrativ i FSHGJ-së.
2. Sekretariati i përgjithshëm drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Komiteti Drejtues.
3. Struktura e Sekretariatit të Përgjithshëm dhe funksionimi i tij përcaktohen në rregulloren e hartuar nga Komiteti Drejtues dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Adresa: Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm;

- a. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
- b. Të ketë arsim të lartë, cikli i arsimit Bachelor plus "Master Profesional" ose "Master Shkencor".
- c. Të ketë njohuri sipas testeve ndërkombëtare në nivelin të paktën B1 të gjuhës angleze.
- d. Të ketë figurë të pastër morale;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës prerë për kryerjen e një vepre penale nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja;
- f. Të mos jetë njëkohësisht anëtarë i një federatë tjetër.
- g. Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.

## Neni 15


### Funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Sekretariati i përgjithshëm ka detyrat e mëposhtme;
2. Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sekretariatit të përgjithshëm dhe për menaxhimin e stafit që punon brënda tij.
3. Të zbatojë vendimet e Komitetit Drejtues dhe Asamblesë së Përgjithshme.
4. Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e organeve të tjera dhe komisioneve.
5. Të programojë rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe të takimeve të K.D-së.
6. Të mbajë korrespondencën e FSHGJ-së.
7. Të mbajë librat e llogarisë e FSHGJ-së.
8. Merrë pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme, takimet e KD-së dhe në atë të komiteteve këshilues në një rol këshillues. Nëse ai nuk është në gjëndje të marrë pjesë duhet të caktojë një zëvendës.
9. Të informojë strukturat përkatëse shtetërore për menaxhimin e grandit, financimeve apo lehtësimeve fiskale që bën shteti për Federatën.

## Neni 16

### Presidenti i nderit dhe Anëtarët e Nderit

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



Me propozim të Komitetit Drejtues, Asambleja e Përgjithshme mundet të japë titullin e Presidentit të Nderit ose të Anëtarit të Nderit cdo personi për merita të vecanta në shërbim të sportit të Gjimnastikës.

Presidenti i Nderit ose Anëtari i nderit mund të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme.

Ata mund të diskutojnë por nuk kanë të drejtë vote.

Titujt e nderit të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme, i delegohen Komitetit Drejtues për shqyrtim, i cili vendos sipas rastit.

- a. Nderi i "Sportit të Gjimnastikës" Medalje e Artë
- b. Nderi i "Sportit të Gjimnastikës" Medalje e Argjente
- c. Nderi i "Sportit të Gjimnastikës" Medalje e Bronxtë

## KREU IV

### FINANCA

#### Neni 17

#### Periudha financiare

Periudha financiare për Federatën do të jetë viti kalendarik.

#### Neni 18

#### Burimet financiare, sponsorizimet dhe reklamimet

1. Të ardhurat e FSHGJ sigurohen nga:
  - a. Fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit, në formë transferte, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit, si dhe burime të tjera të ligjshme. Mënyra e përdorimit të këtij fondi përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit përgjegjës për Sportin. Ministria përgjegjëse për Sportin mbikëqyr dhe kontrollon administrimin e transfertës së Buxhetit të Shtetit në të gjitha organizatat sportive që kanë përfituar nga fondet publike;
  - b. Regjistrimet vjetore të anëtarëve;
  - c. Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon FSHGJ
  - d. Nga sponsorizimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti dhe burime të tjera të lejuara;
  - e. Nga tarifat e licencimit të trajnerëve, sportistëve, specialistëve dhe formimi profesional i amatorëve, etj.;

Adresa: Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



- f. Nga kuotat e anëtarësimit të Klubeve sportive, Shoqatave sportive dhe Shoqërive sportive në FSHGJ.
2. Klubet sportive ose Shoqatat e gjimnastikës, në përputhje edhe me rregulloret e FSHGJ, kanë të drejtë të vendosin në uniformat që përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive emrin e shoqërisë sponsorizuese, të shoqërisë sportive ose klubit sportiv në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e sponsorizimit ndërmjet klubit/Shoqatës, FSHGJ ose sportistëve dhe sponsorizuesit. Kontratat hartohen në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe sipas standardeve dhe rregulloreve ndërkombëtare. Madhësia dhe forma e mbishkrimeve duhet të jenë në përputhje me normat e rregullores së federatës përkatëse sportive dhe me aktet ligjore në fuqi.
  3. Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku ata zhvillojnë veprimtarinë sportive, për qëllime reklamimi ose sponsorizimi me personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese të lidhura me to.

## KREU V

### SPORTISTI, KATEGORITË E SPORTISTËVE, TRAJNERI

#### Neni 19 Sportisti

1. Sportisti ka të drejtë ta zgjedhë vetë shoqatën sportive, shoqërinë sportive, klubin sportiv ku dëshiron të anëtarësohet dhe ta ndryshojë atë në përputhje me statutet e tyre dhe rregulloret e përcaktuara nga FSHGJ.
2. Pjesëmarrja e sportistit në këto organizata bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statut dhe në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Sportisti është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës.
3. Transferimi i sportistit të Gjimnastikës nga një klub sportiv në një tjetër, brenda ose jashtë vendit, bëhet në përputhje me rregulloret e veprimtarive sportive të miratuara nga FSHGJ dhe nga Federata Ndërkombëtare e Gjimnastikës (International Gymnastics Federation).

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



## Neni 20

### Kategoritë e sportistëve

1. Sportistët ndahen në amatorë dhe profesionistë, sipas kushteve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloret e FSHGJ.
2. Sportistë amatorë të Gjimmastikës janë ata sportistë, që praktikojnë sportin e Gjimmastikës dhe nuk kanë ndonjë kontratë pune të lidhur me klubin sportiv apo shoqatën sportive ku janë regjistruar, edhe pse ushtrojnë këtë profesion.
3. Sportistët profesionistë të Gjimmastikës janë ata persona që praktikojnë sportin e Gjimmastikës si një profesion dhe fitojnë të ardhura në bazë të nënshkrimit të kontratës së punës me shoqatat, shoqëritë apo klubet sportive në të cilat ata janë anëtarë.

## Neni 21

### Statusi i sportistit të nivelit të lartë

Sportistët e Gjimmastikës të cilët përfitojnë statusin e nivelit të lartë në përputhje me Ligjin për Sportin 79/2017 i ndryshuar, klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare: "rekord olimpik", "rekord botëror", "rekord european", "rekord mesdhetar" "rekord ballkanik", vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpikë", "vendi i parë deri në të tetin në kampionate botërore" dhe "vendi i parë deri në të gjashtin në kampionate europiane", vendi i parë deri në të tretë në Lojërat Mesdhetare dhe vendi i parë në Kampionatin Ballkanik.

Në veprimtari kombëtare zyrtare: "sportisti i cili thyen rekordin kombëtar" dhe "vendi i parë në Kampionatin Kombëtar dhe Kupën e Republikës".

## Neni 22

### Trajneri

1. Klubet sportive, shoqatat dhe shoqëritë sportive anëtare të FSHGJ duhet të punësojnë trajnerë të licencuar nga FSHGJ dhe të nënshkruajnë kontratë punësimi, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.
2. Klubet sportive, shoqatat, shoqëritë sportive dhe FSHGJ, kanë përgjegjësi për kualifikimin dhe trajnimin e mëtijshëm të trajnerëve në bashkëpunim me institucione përkatëse të fushës.

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"

22



## Neni 23

### Detyrimet e sportistit dhe trajnerit

1. Sportisti i Gjimnastikës duhet të respektojë rregullat e FSHGJ dhe të Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës (International Gymnastics Federation), parimet etike të sportit dhe të *fair-play*-t, kushtet e Konventës Ndërkombëtare të Antidopingut dhe rregulloret e veprimtarisë së Gjimnastikës.
2. Trajnerët respektojnë rregullat e *fair-play*-t, parimet e Kodit të Etikës, Konventën Ndërkombëtare të Antidopingut, si dhe rregulloret e FSHGJ-së.

## KREU VI

### INFRASTRUKTURA SPORTIVE

## Neni 24

### Ndërtimi dhe përdorimi i objekteve sportive

1. Objektet sportive ndërtohen dhe përdoren sipas rregullave teknike, higjeno-shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Standardet, kontrolli, mbikqyrja e objekteve sportive parashikohen në rregulloren mbi ndërtimin dhe përdorimin e këtyre objekteve.
3. Objektet sportive publike janë në pronësi të pushtetit qendror ose atij vendor, sipas juridiksionit të tyre, ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe rikonstruktimin e tyre.

## KREU VII


### DREJTËSIA SPORTIVE

## Neni 25

### Shqyrtimi administrativ

1. FSHGJ-ja krijon organet e gjyqimit disiplinor, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.

*[Handwritten signature]*



Adresa: Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.





2. Organet e gjykimit disiplinor të FSHGJ-së shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë, garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës së FSHGJ-së.
3. Vendimet e organeve të gjykimit disiplinor të FSHGJ, mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) brenda 15-ditëve kalendarike nga shpallja e tyre.


## Neni 26

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. FSHGJ ja pranon autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv. Vendimet e organeve drejtuese të FSHGJ që bien në kundërshtim me ligjin dhe me këtë Statut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit të Gjimnastikës, ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS), organ i ngritur pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Të gjitha organizatat sportive të Gjimnastikës dhe çdo sportist apo trajner me titull individual në sportin e Gjimnastikës, kanë të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe mosmarrëveshjet.
2. Vendimet e paneleve të arbitrave/ndërmjetësve ankimohen pranë Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) brenda 30-ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) shqyrton ankimin brenda 30-ditëve dhe merr vendim.
3. Vendimet e këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) shqyrton ankimin brenda 30-ditëve dhe merr vendim.
4. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, FSHGJ, klubet dhe shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe çdo sportist apo trajner me titull individual në sportin e Gjimnastikës, pranojnë autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS). FSHGJ njuh dhe zbaton vendimet që merr këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) për vete dhe për anëtarët e saj.
5. Vendimet e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (CAS), në Lozanë të Zvicrës.

## KREU VIII

### ANTIDOPINGU, KONTROLLI MJEKËSOR NË SPORT DHE SIGURIMI SHËNDETËSOR I SPORTISTËVE





Neni 27

**Përdorimi i substancave dhe metodave doping**

1. FSHGJ-ja pranon autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping për kontrollin e sportistëve, anëtarëve të tyre dhe dënimin e përdoruesve të dopingut.
2. Në procesin stërvitor dhe në veprimtaritë sportive të sportit të Gjimnastikës është i ndaluar përdorimi i substancave dhe metodave doping.
3. Lista e substancave dhe metodave doping të ndaluara në Republikën e Shqipërisë është e njëjtë me ato të miratuara nga Agjencia Botërore e Antidopingut.
4. Përdorimi i substancave dhe metodave doping, si dhe nxitja për përdorimin e tyre dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga FSHGJ.

Neni 28

**Dispozita të veçanta në lidhje me dopingun**

1. FSHGJ njeh dhe merr përsipër të zbatojë sanksionet mbi Anti-dopingun dhe Feminitetin, konform rregullores së Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës (International Gymnastics Federation) në këtë fushë.
2. FSHGJ njeh autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping në ushtrimin e kontroleve antidoping me sportistët anëtarë të FSHGJ.
3. FSHGJ dhe të gjithë organizatat sportive anëtare të saj, pranojnë masat disiplinore dhe dënimet e dhëna nga Organizata Kombëtare Antidoping dhe Federata Ndërkombëtare e Gjimnastikës (International Gymnastics Federation) për sportistët anëtarë të FSHGJ që rezultojnë pozitiv në këto kontrole.
4. FSHGJ dhe Organizata Kombëtare Antidoping, si dhe të gjitha organizatat sportive të Gjimnastikës anëtare të FSHGJ janë të detyruara të respektojnë antidopingun sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e Konventës Ndërkombëtare Kundër Dopingut në Sport, 2005, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9623, datë 16.10.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër Dopingut në Sport, 2005", dhe Konventës Europiane Antidoping të vitit 1989, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9242, datë 17.6.2004, "Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989".


Neni 29

**Kontrolli mjekësor në sport**



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"

25



1. Asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në FSHGJ dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive të organizuara prej saj, pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur. Sportistët e gjimnastikës të anëtarësuar në FSHGJ pajtohen me kartelë mjekësore vetjake.
2. Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga mjekë të licensuar, të paktën një herë në 6-muaj, për matjen e parametrave jetësorë.
3. Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare të Gjimnastikës bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Qendrës së Shërbimit të Sportit dhe Përgatitjes së Ekipeve Kombëtare.
4. Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.

## Neni 30

### Sigurimi shëndetësor i sportistëve

1. Organizatat sportive (klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive) anëtare të FSHGJ, janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë sportive të Gjimnastikës.
2. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve që mund t'u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.
3. Organizata sportive (klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive) anëtare të FSHGJ, që lejojnë pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive e sportistëve të Gjimnastikës të pasiguruar nga ana shëndetësore, detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit në rast dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. FSHGJ është përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve të ekipeve kombëtare gjatë grumbullimeve stërvitore dhe pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare të Gjimnastikës.

## KREU IX

### PARANDALIMI I DHUNËS NË SPORT

Adresa: Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.





Neni 31

Ndalimi i provokimeve dhe i sjelljeve të palejuara

1. Gjatë veprimtarive sportive të Gjinnastikës të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve.
2. Gjatë veprimtarive sportive të Gjinnastikës, të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohen sjelljet e palejuara të mëposhtme:
  - a. sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve;
  - b. gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve;
  - c. shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyhen ndjenjat kombëtare ose ndjenjat e tjera ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor;
  - d. ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike;
  - e. dëmtimi i mjedisve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv;
  - f. veprimet me të cilat pengohet hyrja apo dalja e pjesëmarrësve në mjedisin sportiv, pengimi i zhvillimit të veprimtarisë sportive apo shkaktimi i pasigurisë në mjedisin sportiv për pjesëmarrësit apo personat e tjerë;
  - g. hyrja e paautorizuar në hapësirat e mjedisit sportiv dhe të terrenit sportiv;
  - h. hyrja e paautorizuar në hapësirat zyrtare dhe në kalimet zyrtare të mjedisit sportiv ose në pjesën e tribunës që i caktohet tifozëve të ekipit mik;
  - i. djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj., ose e sendeve të tjera në mjedisin sportiv;
  - j. përdorimi i maskave ose sendeve të tjera, me qëllim fshehjen e identitetit ose fshehjen e fytyrës;
  - k. trukimi i rezultateve të veprimtarive sportive.
3. Organizatori i veprimtarisë sportive të Gjinnastikës është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarisë sportive dhe, në veçanti, të kujdeset për marrjen e masave parandaluese të shfaqjes së provokimeve e të sjelljeve të tjera të palejuara.





4. FSHGJ, në veprimtarinë kundër dhunës në Shqipëri, respektojnë dispozitat e Konventës Europiane Kundër Dhunës në Sport ku aderon Republika e Shqipërisë.

**Neni 32**

**Sendet e palejuara në objektet dhe mjediset sportive**

1. Ndalohen mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjediset sportive të Gjimnastikës dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.
2. Gjatë veprimtarive sportive të Gjimnastikës, personat në cilësinë e përfaqësuesit të FSHGJ, gjyqtarëve dhe vëzhguesve, janë të paprekshëm.

**Neni 33**

**Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike**

1. Organizatori i një veprimtarie sportive në Gjimnastikës është i detyruar të njoftojë Policinë e Shtetit me shkrim të paktën 7-ditë kalendrike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarëvajtjen e saj.
2. Në këtë njoftim, organizatorët duhet të përcaktojnë edhe shërbimin privat të sigurisë fizike (SHPSF) të kontraktuar për marrjen e masave të sigurisë në mjediset sportive të Gjimnastikës.
3. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike në mjediset sportive është detyrë institucionale e organeve sipas legjislacionit në fuqi.
4. Administratorët e objekteve dhe mjedisëve sportive, në bashkëpunim me klubet sportivetë Gjimnastikës, nëpërmjet shoqërive priyate të sigurisë fizike (SHPSF), duhet të marrin këto masa:
  - a. të kryejnë kontrollin rigoroz të tifozëve në portat e hyrjeve në mjedisin sportiv;
  - b. të kryejnë sigurimin e vendkalimeve publike në mjedisin sportiv;
  - c. të kryejnë drejtimin e spektatorëve tek ulëset në mjedisin sportiv dhe mbajtjen e tyre nën kontroll;
  - d. të kryejnë sigurimin dhe mbrojtjen e lojtarëve nga futja e tifozëve në mjedisin sportiv.
3. Administratorët e mjedisëve sportive marrin masat për caktimin e një ambienti të përshtatshëm për drejtuesit e njësisë policore për monitorimin e situatës së rendit publik në mjedisin sportiv.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"



## Neni 34

### Roli i oficerit të sigurisë në veprimtaritë ndërkombëtare

1. Në veprimtaritë ndërkombëtare të Gjimnastikës brenda dhe jashtë vendit, FSHGJ merr masa për sigurinë e ekipeve kombëtare nëpërmjet kontaktimit të oficerit të sigurisë.
2. Oficeri i sigurisë duhet:
  - a. Të ketë qenë në nivelin drejtues në Policinë e Shtetit;
  - b. Të ketë përvojë në organizimin dhe menaxhimin e masave të sigurisë gjatë veprimtarive sportive;
  - c. Të ketë gatishmërinë për të punuar me autoritetet publike dhe të Policisë së Shtetit.
3. Oficeri i sigurisë mban kontakte me autoritetet policore, shërbimet e urgjencës dhe përfaqësuesit e tifozëve. Ai është përgjegjës për vlerësimin dhe raportimin tek organizatori i veprimtarisë sportive, duke marrë masat që ato të mos ndikojnë në sigurinë e veprimtarisë.
4. Oficeri i sigurisë është përgjegjës për vlerësimin e adresimin e rreziqeve dhe për marrjen e masave në koordinim me policinë, shërbimet e emergjencës, autoritetet publike dhe çdo subjekt tjetër të përfshirë në menaxhimin e ngjarjes.

## KREU X

### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE TË FUNDIT

## Neni 35

### Dispozita te fundit

1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut ose, për çështje të forcave madhore do të zgjidhen duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.79/2017 "Për Sportin", Kodit Civil, ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" të ndryshuar, ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" të ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Çdo ndryshim i Statutit të FSHGJ, përpara se të regjistrohet në Gjykatën kompetente, miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për Sportet.
3. Në rast mosmarrëveshjesh brenda FSHGJ, të cilat çojnë një paralizimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së FSHGJ, mosmarrëveshje ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive ose ndërmjet tyre dhe të punësuarve zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin dhe rregullat e FSHGJ, në të kundërt palët duhet t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.



# FEDERATA SHQIPTARE E "GJIMNASTIKËS"

## Neni 36 Hyrja në fuqi


Ky Statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiskionit të Përgjithshëm, Tiranë.

*Adriatik Mebe*

Nënshkruar nga përfaqësuesi i Autorizuar



24



Adresa:Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë.

